ANALIZË (përmbledhje)

E QASJES NË DREJTËSINË ADMINISTRATIVE SOCIALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



Financuar nga Bashkimi Evropian

BE-ja me TY

Instituti për të Drejtat e Njeriut

Analizë e qasjes në drejtësinë administrative sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Botues:
Instituti për të Drejtat e Njeriut

Për botuesin:
Margarita Caca Nikollovska

Redaktori:
Dr. Vesna Stefanovska

Autorët:
prof. Dr. Ivana Shumanovska Spasovska
doc. Dr. Konstantin Bitrakov

Përkthimi:
Blerina Starova-Zllatku

Dizajni grafik:
Bisera Atanasovska

Shkup, 2026

Ky publikim u punua me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

CONTENTS

1. VËREJTJE HYRËSE 4
   1.1. Sfondi: çfarë përfaqëson drejtësia administrative sociale dhe cili është qëllimi i kësaj analize 4
   1.2. Subjekti i analizës, pyetjet, struktura, fushëveprimi dhe afati kohor 5

2. IDENTIFIKIMI DHE PARAQITJA E PROBLEMEVE SISTEMATIKE DHE TË PËRSËRITURA PËRMES ANALIZËS SË JURISPRUDENCËS 6

   2.1. Dispozita të rëndësishme të Ligjit për konteste administrative dhe gjyqësore në fushën e të drejtave sociale 6
   2.2. Të dhëna statistike për kontestet para Gjykatës Administrative 7
   2.3. Shkelje e parimit të përcaktimit të së vërtetës materiale 10
   2.4. Aplikimi i gabuar i së drejtës materiale 11
   2.5. Mosrespektimi i aktgjykimeve dhe udhëzimeve të gjykatës 11
   2.6. Shkelje të tjera 12

3 VËREJTJE PËRMBYLLËSE 13
   3.1. Konkluzione të përgjithshme për qasjen në drejtësinë sociale administrative 13
   3.2. Konkluzione mbi kuadrin ligjor 13
   3.3. Konkluzione mbi zbatimin e ligjit procedural administrativ 13
   3.4. Konkluzione mbi kuadrin institucional 14
   3.5. Konkluzione në lidhje me mbrojtjen administrativo-gjyqësore 14
   3.6. Konkluzion i përgjithshëm 14
   3.7. Rekomandime 15

1. VËREJTJE HYRËSE

1.1. Sfondi: çfarë përfaqëson drejtësia administrative sociale dhe cili është qëllimi i kësaj analize

Objektivi i përgjithshëm i projektit "Nisma për Drejtësi Administrative Sociale" i zbatuar nga Instituti për të Drejtat e Njeriut, dhe në kuadër të të cilit është përgatitur kjo analizë, është përmirësimi i qasjes në drejtësinë administrative sociale për grupet e margjinalizuara dhe të cenueshme duke forcuar kapacitetet institucionale dhe të organizatave të shoqërisë civile. Në kuadër të këtij objektivi të përgjithshëm, objektivi konkret i analizës është përcaktimi i situatës aktuale në lidhje me qasjen në drejtësinë administrative sociale. Përcaktimi i situatave aktuale në lidhje me qasjen në drejtësinë administrative sociale është i nevojshëm për të përshkruar masat dhe veprimet e bazuara në prova për të përmirësuar atë qasje. Për të kuptuar më mirë qëllimin konkret të analizës së vendosur në këtë mënyrë, është e nevojshme, para së gjithash, të shtjellohet se çfarë nënkuptohet me qasje në drejtësinë administrative sociale. Menjëherë vërehet se është një term që rrjedh nga ai më i përgjithshëm, që është termi qasje në drejtësi.[1]

Qasja në drejtësi mund të nënkuptojë koncepte të ndryshme. Në kuptimin më të ngushtë, qasja në drejtësi nënkupton vetëm mundësinë e një personi për t'u paraqitur në gjykatë kur të drejtat, detyrimet dhe interesat e tij janë në rrezik.[2] Në një kuptim më të gjerë, kur flasim për qasjen në drejtësi, flasim për kontekstin më të gjerë shoqëror të sistemit gjyqësor dhe (mos)ekzistencën e barrierave sistemike për realizimin e të drejtave të individëve (Alberta Civil Liberties Research Centre). Sot, kur flasim për qasjen në drejtësi, më së shpeshti flasim për kuptimin më të gjerë të këtij termi. Siç thekson Instituti për të Drejtat e Njeriut (Извештај за пристап до правда: 2022 година, 2022, стр. 3), përkufizimi më i gjerë i qasjes në drejtësi përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për t'u mundësuar qytetarëve të ushtrojnë të drejtat e tyre: një kornizë ligjore që u garanton qytetarëve të drejta gjithëpërfshirëse dhe të barabarta; ndërgjegjësim të gjerë juridik të popullsisë për të drejtat e tyre; qasje të lehtë në këshilla juridike dhe cilësore si dhe përfaqësim ligjor; qasje në mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që janë të disponueshëm, në kohë, efektivë, efikasë, të paanshëm, pa korrupsion dhe të besueshëm, dhe që zbatojnë rregulla dhe procedura në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut; si dhe ekzistencën e mekanizmave efektivë dhe të paanshëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Nëse pranojmë kuptimin më të gjerë të qasjes në drejtësi dhe përpiqemi të nxjerrim kuptimin e qasjes në drejtësinë administrative sociale, do të arrinim në përkufizimin e mëposhtëm:

Konkluzion

Qasja në drejtësinë administrative sociale nënkupton ekzistencën e një legjislacioni të përshtatshëm material dhe procedural, të bazuar në parimet përgjithësisht të pranuara të ligjshmërisë, drejtësisë, efikasitetit, orientimit ndaj shërbimit, solidaritetit dhe të ngjashme; zbatimin e tij të qëndrueshëm nga organet publike gjatë miratimit të akteve administrative dhe ndërmarrjes së veprimeve të tjera administrative që lidhen me të drejtat sociale; si dhe një kontroll efektiv administrativ-gjyqësor mbi organet publike, me qëllim sigurimin e ushtrimit të papenguar të të drejtave sociale dhe mbrojtjen nga heqja ose kufizimi arbitrar i tyre.

1 Duke shtuar mbiemrat "administrativ" dhe "social".

2 Ky është kuptimi më i ngushtë i qasjes në drejtësi. Ky koncept i "qasjes në drejtësi" i ka rrënjët në shtetet liberale të shekujve 18 dhe 19 dhe i referohet të drejtës formale të individit për të ngritur padi ose për të mbrojtur veten. Me fjalë të tjera, ky koncept mbulon të drejtën për "të pasur një ditë para gjykatës" (Alberta Civil Liberties Research Centre).

1.2. Subjekti i analizës, pyetjet, struktura, fushëveprimi dhe afati kohor

Duke pasur parasysh se qëllimi i kësaj analize është të përcaktojë situatën aktuale në lidhje me qasjen në drejtësinë administrative sociale, subjekti i saj është:

- kuadri ligjor për ushtrimin e të drejtave sociale në procedurat administrative,
- kuadri institucional për ushtrimin e të drejtave sociale (cilat institucione veprojnë në procedurë administrative),
- praktika e gjyqësorit administrativ, si dhe
- problemet sistemike që mund të ekzistojnë.

Duke pasur parasysh subjektin e tillë, pyetjet të cilat synojmë t'i përgjigjemi në analizë janë në vijim:

- nëse është i përshtatshëm kuadri ligjor për ushtrimin e të drejtave sociale, nëse dhe si mund të përmirësohet,
- si të neutralizohen, në afat të gjatë, problemet sistematike që lidhen me ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave sociale, veçanërisht duke marrë parasysh zgjidhjen e këtyre të drejtave në procedurat administrative dhe kontestet administrative?

Për sa i përket fushëveprimit të kësaj analize, megjithatë, vlen të përmendet se nuk do të mbulohen të gjitha të drejtat sociale[3]. Në të, i referohemi të drejtave të mbrojtjes sociale, të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor dhe të drejtave të sigurimit shëndetësor. Ka dy arsye për këtë qasje. Para së gjithash, këto tre nëngrupe të të drejtave kërkojnë veprim më aktiv nga shteti.[4] Për të ushtruar të drejtat e tyre të mbrojtjes sociale, sigurimit pensional dhe invalidor dhe sigurimit shëndetësor, palët zakonisht duhet të hyjnë në një marrëdhënie administrative-juridike që do të rezultojë në një akt administrativ ose veprim tjetër administrativ. Për më tepër, do të ishte tejet ambicioze të mbuloheshin të gjitha të drejtat sociale në një analizë. Sa i përket kornizës kohore të analizës, ajo mbulon kryesisht pesë vitet e fundit (domethënë kryesisht do të vëzhgohet praktika e autoriteteve publike dhe gjyqësorit administrativ gjatë kësaj periudhe).

Në fund, domethënia e analizës lind nga vetë kuptimi i të drejtave sociale: ato janë thelbësore nga pikëpamja e dinjitetit njerëzor dhe realizimi dhe mbrojtja e tyre lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e shoqërisë dhe shtetit.

3 Të drejtat sociale nënkuptojnë qasjen në ushqim, shëndetësi, arsim, strehim, mbrojtje sociale, si dhe të drejtat e punës, të cilat janë të domosdoshme për dinjitetin njerëzor (Commissioner for Human Rights - Council of Europe, 2025). Të drejtat sociale më së shpeshti grupohen së bashku me të drejtat ekonomike dhe kulturore dhe si grup ekzistojnë paralelisht me të drejtat civile dhe politike. Në nivel universal, dokumenti më i rëndësishëm për këto të drejta është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, megjithatë, të drejtat sociale rregullohen me Kushtetutë (Gazeta Zyrtare Nr. 52/1991... 6/2019), ku atyre iu kushtohet një kapitull i veçantë (nenet 30 deri 49).

4 Kështu, për shembull, shteti duhet të veprojë në mënyrë shumë më të theksuar, domethënë të përmbahet nga shkeljet e së drejtës për strehim (megjithëse kategori të caktuara të qytetarëve duhet t'iu sigurohet një shtëpi). Në të kundërt, shteti duhet të sigurojë në mënyrë aktive kujdesin shëndetësor, ai nuk mund të përmbahet nga ndërmarrja e veprimeve.

2. IDENTIFIKIMI DHE PARAQITJA E PROBLEMEVE SISTEMATIKE DHE TË PËRSËRITURA PËRMES ANALIZËS SË JURISPRUDENCËS

2.1. Dispozita të rëndësishme të Ligjit për konteste administrative dhe gjyqësore në fushën e të drejtave sociale

Me Ligjin për kontestet administrative rregullohen kompetencat, përbërja e gjykatës dhe procedura në të cilën vendoset për kontestet administrative, si dhe zbatimi i aktgjykimeve gjyqësore të miratuara. Në kontest administrativ sigurohet mbrojtje gjyqësore e të drejtave dhe interesave juridike të personave fizikë dhe juridikë kundër akteve administrative individuale dhe veprimeve të organeve publike, në përputhje me këtë ligj. Ky ligj ka rëndësi të veçantë për realizimin e mbrojtjes administrativo-gjyqësore të personave fizikë dhe juridikë, kur ata kundërshtojnë ligjshmërinë e një akti administrativ të formës së prerë. Gjegjësisht, kjo mbrojtje administrativo-gjyqësore e palëve është e garantuar edhe me kushtetutë. Me Ligjin për kontestet administrative në thelb rregullohet procedura administrativo-gjyqësore, përmes së cilës, nga njëra anë, ushtrohet kontroll mbi ligjshmërinë e akteve administrative të miratuara nga organet publike, si dhe mbi mosveprimin e organeve brenda afateve të përcaktuara me ligj, dhe nga ana tjetër sigurohet mbrojtja e të drejtave dhe interesave të palëve. Gjatë marrjes së vendimeve gjyqësore, veçanërisht të rëndësishme janë dispozitat që kanë të bëjnë me kompetencën e Gjykatës Administrative, si dhe dispozitat që lidhen me llojin e vendimit dhe mënyrën e marrjes së tij. Për shembull, neni 3, i cili i referohet objektit të kontestit administrativ, është veçanërisht i rëndësishëm për përcaktimin e çështjeve për të cilat është kompetente Gjykata Administrative; nëse një çështje e tillë nuk parashihet në këtë nen, gjykata mund ta hedhë poshtë padinë si të paraqitur pranë një organi jokompetent për vendimmarrje mbi çështjen përkatëse. Parimi i seancës gojore, i parashikuar në nenin 9, është një nga risitë thelbësore në Ligjin për kontestet administrative, sipas të cilit gjykata, si rregull, merr vendim në një kontest administrativ mbi bazën e një seance publike, të drejtpërdrejtë dhe gojore, ndërsa përjashtime nga zbatimi i këtij parimi ekzistojnë vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj. Lidhur me këtë nen është edhe neni 37, në të cilin përcaktohet se gjykata vendos mbi padinë e paraqitur pas mbajtjes së seancës, përveç rasteve kur me këtë ligj është parashikuar ndryshe. Veçanërisht e rëndësishme është risia në ligjin për kontestet, e cili parashikohet në nenin 7, i cili rregullon parimin e ligjshmërisë. Sipas nenit 58 parashihet një nga llojet e vendimeve që merr gjykata, i cili është aktgjykimi, dhe përcaktohet se me aktgjykim gjykata vendos për çështjen kryesore dhe për kërkesat dytësore. Në nenin 59 përcaktohen bazat mbi të cilat gjykata mund ta refuzojë padinë, ndërsa në nenin 60 përcaktohen bazat mbi të cilat gjykata e pranon padinë, duke theksuar se tani kontesti me juridiksion të plotë parashihet si rregull, e jo si përjashtim.

Në lidhje me forcimin e efikasitetit të procedurës administrativo-gjyqësore, dispozitat veçanërisht të rëndësishme të Ligjit për kontestet administrative janë:

- Neni 11, i cili i referohet parimit të efikasitetit, ka rëndësi sepse për herë të parë parashikon një afat kohor për marrjen e vendimit në një kontest administrativ. Në kuadër të këtij parimi të efikasitetit, gjykata do të zhvillojë procedurën shpejt, pa veprime dhe kosto të panevojshme, dhe do të marrë vendimin brenda një afati të arsyeshëm, pra jo më vonë se nëntë muaj nga dita e dorëzimit të dosjeve ose krijimit të kushteve për vendimmarrje mbi padinë.
- Neni 16, i cili parashikon se kontesti mund të zgjidhet edhe nga një gjykatës individual. Pra, parashihet që në kontestin administrativ në shkallë të parë, gjykata vendos në një trup prej tre gjykatësish, ose si gjykatës individual në konteste ku kontesti, i shprehur në vlerë monetare, nuk e tejkalon shumën prej 10,000 eurove në denarë, ose në konteste ku kundërshtohen vetëm veprime procedurale gjatë procedurës për miratimin e aktit administrativ.

- Neni 60, në të cilin përcaktohen bazat mbi të cilat gjykata e pranon padinë, duke theksuar se tani kontesti me juridiksion të plotë parashihet si rregull dhe jo si përjashtim.
- Neni 88, i cili i referohet zbatimit të vendimeve gjyqësore, parashikon se kur aktgjykimi anulon një akt të të pandehurit pa vendosur mbi çështjen administrative, i pandehuri do të veprojë në përputhje me urdhrin e aktgjykimit brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të tij. Nëse i pandehuri nuk vepron sipas aktgjykimit brenda afatit të përcaktuar dhe nuk respekton opinionin ligjor dhe udhëzimin e gjykatës, gjykata vendos një gjobë deri në 20% të pagës mujore të personit të autorizuar ose përgjegjës në organin publik. Ndërsa, për zbatimin e aktgjykimit me të cilin gjykata ka vendosur mbi çështjen administrative me juridiksion të plotë, i pandehuri është i detyruar brenda afateve të përcaktuara në aktgjykim të ndërmarrë veprimet e përcaktuara ose të urdhëruara në aktgjykim.
- Neni 36, i cili ka rëndësi jo vetëm për efikasitetin, por edhe për tejkalimin e problemit që lind në praktikë, që është mosdërgimi i dosjeve nga organi i paditur te Gjykata Administrative. Në Ligjin për kontestet administrative parashihet se, në kërkesë të gjykatës, çdo organ publik është i detyruar, në përputhje me ligjin, të dorëzojë të gjithë dokumentet dhe të dhënat që ka në dispozicion dhe që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes konkrete, brenda afatit të caktuar nga gjykata. Nëse organi publik nuk vepron, gjykata, me vendim, vendos një gjobë deri në 20% të pagës mujore të personit të autorizuar ose përgjegjës në organin publik, i cili pa arsye nuk ka dorëzuar dokumentet ose të dhënat që ka në dispozicion.

2.2. Të dhëna statistike për kontestet para Gjykatës Administrative

Të dhënat[5] tregojnë se numri i padive të ngritura për shkelje të të drejtave të mbrojtjes sociale është relativisht i kufizuar dhe me tendencë rënieje ose stagnimi të lehtë në periudhën e analizuar. Për shembull, tek paditë për ndihmën minimale të garantuar vihet re një ulje nga 105 padi në vitin 2021 në 54 padi në vitet 2023 dhe 2024. Një tendencë e ngjashme në rënie vërehet në ndihmën dhe kujdesin ndaj një personi tjetër (nga 121 padi në vitin 2021 në 69 padi në vitin 2024), si dhe në kompensimin monetar për dëmin trupor. Këto të dhëna tregojnë se, edhe pse të drejtat nga mbrojtja sociale realizohen në masë në praktikë, gjë që nënkupton mijëra kërkesa, vetëm në një pjesë të vogël të rasteve niset mbrojtja administrativo-gjyqësore. Në të njëjtën kohë, numri i padive është i vogël *vis-à-vis* numrit të vendimeve që refuzojnë kërkesat për ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale.

Tabela Nr. 4 – Të dhëna për paditë e ngritura në lëndët e të drejtave sociale dhe kërkesat e miratuara

Viti	2021	2022	2023	2024
Numri i padive të ngritura në bazë të "ndihmës sociale të garantuar"	105	63	54	54
Numri i padive të miratuara në bazë të "ndihmës minimale të garantuar"	45	22	28	15
Numri i padive të ngritura në bazë të "kompensimit monetar për dëmin trupor"	23	23	10	15
Numri i padive të miratuara në bazë të "kompensimit monetar për dëmin trupor"	11	9	7	7

5 Të dhënat janë marrë duke iu përgjigjur një kërkese për qasje në informacionin publik të dërguar në tetor 2025, e cila u miratua me Vendimin nr. 0819 SPINR 03-18/25 datë 20.10.2025 miratuar nga Gjykata Administrative.

Numri i padive të ngritura në bazë të "ndihmës dhe kujdesit ndaj një personi tjetër"	121	95	85	69
Numri i padive të miratuara në bazë të "ndihmës dhe kujdesit ndaj një personi tjetër"	99	67	51	44
Numri i padive të ngritura në bazë të "ndihmës të njëherëshme monetare"	9	13	17	19
Numri i padive të miratuara në bazë të "ndihmës të njëherëshme monetare"	4	7	9	7
Numri i padive të ngritura bazuar në kompensimin e pagës për orar të shkurtuar të punës	Sipas sistemit AKMIS, regjistrohet si "të drejtat të sigurimit shëndetësor i detyrueshëm", ku regjistrohen kompensime nga shumë baza të ndryshme që rrjedhin nga të drejtat e sigurimit shëndetësor të detyrueshëm (sëmundje, dëmtim trupor – aftësi të kufizuara, shtatzëni etj.), prandaj nuk mund të nxirret një e dhënë e saktë për bazën e kërkuar.			
Numri i padive të ngritura në bazë të "shtesë për banim "	Nuk regjistrohet numri i padive të ngritura mbi bazën "shtesë për banim" në sistemin AKMIS, për këtë arsye nuk mund të nxirren të dhëna të sakta mbi bazën e kërkuar			
Numri i padive të ngritura në bazë të "sigurimeve sociale për të moshuarit"	Sipas sistemit AKMIS, regjistrohet si "mbrojtje sociale" së bashku me bazat e tjera në një fushë të ngjashme, për shkak të së cilës nuk mund të nxirren të dhëna të sakta statistikore për numrin e padive të pranuara mbi bazën e kërkuar.			

Nëse vëzhgojmë të dhënat e përgjithshme për lëndët e regjistruara nën numrin U-4,[6] që janë praktikisht lëndët e interesit tonë, do të shohim se ka një numër të vogël lëndësh për të drejtat e tjera sociale (përveç të drejtave të mbrojtjes sociale).

Megjithatë, edhe pse numri i padive është relativisht i vogël, mund të vërehet se ekziston një numër konstant i padive të pranuara (konkretisht, pothuajse gjysma e padive pranohen gjithmonë në rastet e ndihmës minimale të garantuar). Kjo tregon se, edhe pse numri i padive është relativisht i vogël, ato paraqiten në rastet kur vërtet ekzistojnë shkelje që e bëjnë aktin administrativ të paligjshëm. Megjithatë, për fat të keq, këto të dhëna nuk mund të arrihen përmes raporteve vjetore të Gjykatës Administrative, prandaj duhet të paraqitet një kërkesë për qasje në informacionin publik. Në të ardhmen, raportet vjetore të gjykatës duhet të japin gjithashtu të dhëna se sa nga paditë janë pranuar, refuzuar (ose hedhur poshtë), dhe sa herë është vendosur në juridiksion të plotë.

Për sa i përket efikasitetit të procedurës administrativo-gjyqësore, për ilustrim tregojmë vitin 2024, në fushën e lëndëve të regjistruara me numër U-4.

6 Konteste administrative në fushën e pensioneve, të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, si dhe të drejtave të tjera që zgjidhen në departamentin e çështjeve pronësore-ligjore, denacionalizimit, eksproprimit, sigurimit pensional dhe shëndetësor, urbanizmit, ndërtimtarisë, kundërvajtjeve dhe kontesteve të tjera; si dhe konteste administrative në fushën e pensioneve, të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor, dhe të drejtave të tjera që zgjidhen në departamentin e doganave, koncesioneve, partneriteteve publike-private dhe të drejtave të tjera të ngjashme, përfshirë të drejtat nga mbrojtja sociale, kundërvajtjet dhe të drejta të tjera të ngjashme.

Tabela Nr. 5 – Shembull ilustrues i efikasitetit[7]

Lloji i lëndës	Të pazgjidhura	Të sapopranuara	Të regjistruara sërish	Të regjistruara gabimisht	Gjithsej në punim	Të zgjidhura	Të mbetura
U-4	390	477	36	1	902	470	432

Në vijim paraqitet një pasqyrë, sipas departamenteve.

Tabela Nr. 6 – Shembull ilustrues i efikasitetit, sipas departamentit[8]

Lloji i lëndës	Të pazgjidhura	Të sapopranuara	Të reg-jistruara gabimisht	Gjithsej në punim	Të zgjidhura	Të mbetura
U-4 në departa-mentin për çështje pronësore-juridike, de-nacionalizim, ekspro-prijim, të drejta nga sigurimi pensional, invalidor dhe shën-detësor, urbanizëm, ndërtimtari, kundër-vajtje dhe të drejta të tjera të ngjashme.	0	188	0	309	42	267
U-4 në departamentin për dogana, koncе-sione, partneritete publiko-private dhe të drejta të tjera të ngjashme, si dhe të drejta nga mbrojtja sociale, kundërvajtje dhe të drejta të tjera të ngjashme.	390	394	1	593	428	165

Për ta përmbledhur, edhe pse të drejtat e mbrojtjes sociale realizohen çdo ditë përmes qendrave për punë sociale, Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor dhe Fondit për Sigurim Shëndetësor, të dhënat statistikore tregojnë se numri i padive të paraqitura mbi këto baza është relativisht i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të lëndëve që trajtohen nga këto organe.

Nga këtu, në tekstin vijues, gjatë identifikimit dhe paraqitjes së problemeve sistemike dhe të përsëritura në fushën e mbrojtjes sociale, analiza do të fokusohet në ato aktgjykime të marra gjatë pesë viteve të fundit me të cilat pranohen kërkesat paditëse, veçanërisht në rastet e shkeljeve më serioze të të drejtave dhe detyrimeve ligjore nga ana e organeve publike. Me fjalë të tjera, aktgjykimet që paraqiten në tekstin vijues janë përzgjedhur me kujdes, sepse në to evidentohen probleme serioze sistemike dhe të përsëritura në procedurat administrative që lidhen me të drejtat sociale (domethënë, shkelje sistemike të lidhura me drejtësinë administrative sociale). Gjithashtu, duhet pasur parasysh se për hartimin e analizës së aktgjykimeve të përmendura, për të cilat ka nën-tituj në Aneksin 1, duhej të bëhej analizë e disa aktgjykimeve të tjera (duke marrë parasysh se bëhet fjalë për konteste administrative të përsëritura – për të njëjtën lëndë janë sjell disa aktgjykime).

7 Raport mbi punën e Gjykatës Administrative (Управен суд, 2025).

8 Ibid.

2.3. Shkelje e parimit të përcaktimit të së vërtetës materiale

Parimi i përcaktimit të së vërtetës materiale u shpjegua në mënyrë të detajuar në tekstin e mëparshëm. Të kujtojmë, bëhet fjalë për parimin themelor në procedurën administrative, i cili kërkon që organet publike të përcaktojnë të gjitha faktet dhe rrethanat me rëndësi thelbësore për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative.

Aktgjykimet e analizuara nxjerrin në pah një mospërfillje të vazhdueshme dhe sistematike të këtij parimi nga organet administrative:

- **Gjendja faktike e përcaktuar pjesërisht ose gabimisht:**
  - **Në aktgjykimin U-4.nr.6/2024**, Gjykata Administrative ka konstatuar se pretendimet e autoritetit të paditur për kontribute të papaguara për periudhën 03/2021 deri 07/2021 janë në kundërshtim me provat e bashkangjitura, të cilat tregojnë "0.00" për orë të papaguara. Kjo tregon një përcaktim jo të plotë dhe të pasaktë të gjendjes faktike, në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
  - **Aktgjykimi U-4.nr. 512/2023** ka konstatuar se autoritetet administrative kanë përcaktuar gabimisht gjendjen faktike, veçanërisht në lidhje me pamundësinë e përhershme të paditësit për të punuar dhe llogaritjen e të ardhurave, gjë që është në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
  - **Në aktgjykimin U-4. nr.196/2022**, gjykata ka konstatuar se Fondi i Sigurimeve Shëndetësore nuk bëri përpjekje të mjaftueshme për të përcaktuar gjendjen faktike, veçanërisht në lidhje me domosdoshmërinë e procedurave diagnostikuese para trajtimit jashtë vendit për një person të rrezikuar në mënyrë jetike. Kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
  - **Aktgjykimi U-4. nr.113/2024** përmban një seksion ku thuhet se autoritetet kanë përcaktuar në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar gjendjen faktike, duke hedhur poshtë në mënyrë të prerë provat e një gjendjeje të përhershme dhe të rëndë shëndetësore të paditësit. Konstatimi, vlerësimi dhe mendimi i komisionit të ekspertëve nuk janë kryer në bazë të shqyrtimit të drejtpërdrejtë, por vetëm në bazë të dokumentacionit mjekësor, të cilin gjykata e konsideron të pamjaftueshëm për të përcaktuar faktet përkatëse. Kjo bie në kundërshtim me nenin 10 të ligjit "Për procedurën e përgjithshme administrative".
  - **Në aktgjykimin U-4. nr.591/2023**, gjykata konstatoi se autoriteti i shkallës së parë nuk i kishte vlerësuar aspak mosveprimet procedurale dhe nuk kishte marrë parasysh rrethanën nëse ndaj paditësit ishte kryer një ekzaminim i drejtpërdrejtë. Gjithashtu, gjendja faktike është përcaktuar pjesërisht, sepse gjetjet, vlerësimi dhe opinionet e komisionit profesional nuk janë kryer mbi bazën e një ekzaminimi të drejtpërdrejtë, por vetëm mbi bazën e dokumentacionit mjekësor. Kjo bie në kundërshtim me nenin 10 të ligjit "Për procedurën e përgjithshme administrative".
- **Injorimi i provave dhe vendimeve kontradiktore:**
  - Në disa raste, organet administrative kanë vlerësuar provat në mënyrë kontradiktore, duke injoruar gjendjen e mëparshme të përherëshme të paditësve. Për shembull, në **Aktgjykimin U-4. nr.113/2024,** një person me një gjendje të përhershme (verbëri) një herë fiton të drejtën, dhe një herë tjetër, sipas të njëjtave prova, nuk e fiton. Kjo është irracionale dhe tregon një vlerësim selektiv dhe jokonsistent të provave, në kundërshtim me parimin e vlerësimit të lirë të provave të përmendura në nenin 12 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
  - **Në aktgjykimin U-4. nr.101/2023**, autoritetet nuk kanë përcaktuar saktë bazën për llogaritjen e tarifës, sepse nuk kanë marrë parasysh pjesën e ndryshueshme të pagës së paditësit, megjithëse janë paguar kontribute për të. Kjo bie ndesh me parimin e përcaktimit të së vërtetës materiale të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2.4. Aplikimi i gabuar i së drejtës materiale

Aplikimi i gabuar i së drejtës materiale shpesh është pasojë logjike e gjendjes faktike të përcaktuar pjesërisht ose gabimisht. Në aktgjykimet e analizuara, u konkludua se aplikimi i gabuar i së drejtës materiale është një dukuri e zakonshme në sferën e mbrojtjes sociale. Ky është konkluzioni:

- **Interpretim i pasaktë i dispozitave ligjore:**
  - Në **aktgjykimin U-4.nr.101/2023**, organet publike kanë zbatuar gabimisht nenin 16 të Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, i cili përcakton se baza është "shuma mesatare mujore e pagës së paguar mbi të cilën është paguar kontributi". Kjo ka ndodhur duke injoruar pjesën variabile të pagës së paditëses, edhe pse për të janë paguar kontributet.
  - **Aktgjykimi U-4.nr.512/2023** tregon për një zbatim të gabuar të së drejtës materiale në lidhje me paaftësinë e përhershme për punë të paditësit dhe llogaritjen e të ardhurave, veçanërisht në kontekstin e nenit 29, paragrafi 5 të Ligjit për Mbrojtjen Sociale, i cili parashikon rritjen e shkallës ekuivalente për personat me aftësi të kufizuara.
  - Në **aktgjykimin U-4.nr.196/2022**, organi i paditur ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, veçanërisht dispozitat e Rregullores për mënyrën e përdorimit të shërbimeve shëndetësore nga personat e siguruar jashtë vendit, duke mos marrë parasysh se procedurat diagnostikuese janë pjesë e procesit të trajtimit për një person në rrezik për jetën, sipas nenit 30 të Ligjit për Sigurimin Shëndetësor.
  - **Aktgjykimi U-4.nr.113/2024** konstaton një zbatim të gabuar të së drejtës materiale si pasojë logjike e përcaktimit të gabuar të gjendjes faktike, me një përdorim të paqartë dhe kontradiktor të nenit 48, 49 dhe 50 të Ligjit për Mbrojtjen Sociale.
  - Në **aktgjykimin U-4.nr.591/2023**, Gjykata Administrative nënkupton një zbatim të gabuar të së drejtës materiale duke cituar nenin 28, paragrafi 1 dhe nenin 33, paragrafi 1, pika 2 të Ligjit për Mbrojtjen Sociale, të cilat përcaktojnë kushtet për të drejtën e ndihmës minimale të garantuar dhe pasurinë nga e cila mund të sigurohet mbijetesa. Gjykata thekson se duhet të përcaktohet saktë se cila pasuri i përket paditësit dhe nëse prej saj mund të sigurohet mbijetesa.

2.5. Mosrespektimi i aktgjykimeve dhe udhëzimeve të gjykatës

Një nga problemet sistematike më shqetësuese është shpërfillja e shumëfishtë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe udhëzimeve të Gjykatës Administrative nga autoritetet publike. Sipas nenit 13 të ligjit për kontestet administrative, vendimi i formës së prerë i gjykatës është i detyrueshëm për palët dhe autoritetet publike. Gjithashtu, neni 60 paragrafi 5 i të njëjtit ligj përcakton se autoriteti i të pandehurit është i lidhur me mendimin juridik të gjykatës dhe me pikëpamjet e tij në lidhje me procedurën. Konkretisht, nga analiza e mëposhtme, shohim:

- **Anulimet e përsëritura dhe kthimet e lëndëve:**
  - Në **aktgjykimin U-4. nr.6/2024**, Gjykata Administrative tashmë ka anuluar dy herë vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e ka kthyer lëndën në ri-vendim. Përkundër këtyre anulimeve dhe udhëzimeve të mëparshme, autoriteti i paditur përsëri mori një vendim që është i paligjshëm për shkak të gjendjes faktike të përcaktuar pjesërisht dhe gabimisht.
  - **Aktgjykimi U-4.nr.196/2022** është gjithashtu një shembull i një kontesti të përsëritur administrativ, ku Gjykata Administrative tashmë ka rrëzuar një herë vendimin e autoritetit të paditur (U-4. nr.38/2021) dhe e ka kthyer lëndën, por autoriteti i paditur përsëri ka sjell një akt të paligjshëm.
  - **Aktgjykimi U-4. nr.113/2024** është veçanërisht ilustrues, ku ka një mospërfillje të dukshme dhe të vazhdueshme të udhëzimeve të Gjykatës Administrative, e cila në tre aktgjykime të mëparshme ka dhënë udhëzime të qarta për veprim.
  - Në **aktgjykimin U-4.nr.436/2023**, Ministria e Shëndetësisë nuk ka vepruar mbi detyrimin e miratimit të një akti të ri administrativ brenda 15 ditëve pasi vendimi U-4.nr.36/2022 u bë i formës së pre-

rë, gjë që çoi në “heshtjen e administratës”. Kjo është një shpërfillje e drejtpërdrejtë e një vendimi gjyqësor dhe parimit të ligjshmërisë.

- **Injorimi i mendimit juridik të gjykatës:**
  - Në të gjitha rastet e kontesteve të përsëritura administrative, organet administrative nuk i janë përmbajtur mendimit ligjor të gjykatës dhe pikëpamjeve të saj në lidhje me procedurën, siç përcaktohet nga neni 60 paragrafi 5 i ligjit për kontestet administrative, duke kontribuar kështu që procedurat për ushtrimin e mbrojtjes ligjore të jenë joefektive dhe joefikase.

2.6. Shkelje të tjera

Përveç shkeljeve të përmendura më sipër, janë konstatuar edhe shkelje të tjera të përsëritura të së drejtës procedurale dhe parimeve të procedurës administrative, të cilat kontribuojnë në joefikasitet dhe vonesë të drejtësisë:

- **Paqartësia dhe kontradikta në arsyetimin e akteve administrative:**
  - Në **aktgjykimin U-4. nr.6/2024**, vendimi i kundërshtuar ishte i paplotë dhe i hartuar gabimisht, me të mangësi për shkak të të cilave nuk mund të hetohej, arsye të paqarta dhe prova kontradiktor. Kjo bie ndesh me nenin 88 pika 4 të ligjit “Për procedurën e përgjithshme administrative”, i cili kërkon shpjegimin e arsyeve për të cilat është miratuar akti administrativ. Shkelje të ngjashme janë konstatuar në aktgjykimin U-4.no.196/2022.
- **Mosparaqitja e një përfaqësuesi të autoritetit të paditur në seancë publike:**
  - **Në aktgjykimin U-4. nr.6/2024 dhe aktgjykimi U-4. nr.196/2022,** një përfaqësues i autoritetit të paditur nuk është paraqitur në seancën publike, megjithëse ishte i ftuar. Kjo e bën të vështirë sqarimin e fakteve dhe rrethanave.
- **Zvarritja dhe jofikasiteti:**
  - Të gjitha vendimet e analizuara tregojnë një kohëzgjatje jashtëzakonisht të gjatë të procedurave gjyqësore administrative dhe administrativo-gjyqësore.
- **Shkelja e parimit të ndihmës aktive për palën dhe orientimin nga shërbimi:**
  - Në shumicën e rasteve më poshtë, është e qartë se autoritetet publike nuk janë të orientuara drejt shërbimit dhe as nuk kanë ndihmuar palët që, në vetvete, janë në një pozitë të palakmueshme.
- **Heshtja e administratës:**
  - **Aktgjykimi U-4. nr.436/2023** është një shembull i drejtpërdrejtë i “heshtjes së administratës”, ku Ministria e Shëndetësisë nuk ka miratuar një akt administrativ brenda afatit ligjor pas një vendimi të mëparshëm gjyqësor. Kjo është shkelje e nenit 3 pika 2 të Ligjit për Konteste Administrative.

Konkluzion

Problemet e identifikuara të përsëritura janë:
- paqartësia dhe kontradikta në arsyetimin e akteve administrative,
- mosparaqitja e një përfaqësuesi të autoritetit të paditur për të marrë pjesë në seancë publike,
- zvarritja dhe jofikasiteti,
- shkelja e parimit të ndihmës aktive për palën dhe orientimin ndaj shërbimit,
- heshtja e administratës,
- marrja vetëm e aktgjykimeve anuluese, dhe jo e aktgjykimeve në kontest me juridiksion të plotë,
- mosmarrja e vendimeve meritore nga ana e organit të shkallës së dytë.

3 VËREJTJE PËRMBYLLËSE

3.1. Konkluzione të përgjithshme për qasjen në drejtësinë sociale administrative

Analiza e qasjes ndaj drejtësisë administrative sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut tregon se, pavarësisht ekzistencës së një kuadri kushtetues dhe ligjor relativisht solid, realizimi dhe mbrojtja reale e të drejtave sociale në procedurat administrative dhe administrative-gjyqësore vazhdon të përballet me dobësi serioze sistemike. Pajtueshmëria formale e legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe parimet evropiane nuk shoqërohet gjithmonë me zbatim të qëndrueshëm dhe cilësor në praktikë, gjë që ndikon drejtpërdrejt në sigurinë juridike, barazinë e qytetarëve dhe efektivitetin e mbrojtjes ligjore.

Qasja në drejtësinë administrative sociale nuk mund të shihet vetëm si mundësi formale për të nisur një procedurë administrative ose një kontest administrativ. Ajo nënkupton një sistem funksional në të cilin autoritetet publike veprojnë në mënyrë të ligjshme, të paanshme, efikase dhe me ndihmën aktive të palëve (gjegjësisht, respektojnë parimet e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në përgjithësi), dhe gjyqësori administrativ siguron mbrojtje gjyqësore reale dhe në kohë. Analiza tregon se pikërisht në këtë dimension funksional ekzistojnë sfidat më të mëdha.

3.2. Konkluzione mbi kuadrin ligjor

Nga perspektiva e kuadrit normativ, mund të përfundohet se Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative përfaqëson një bazë të fortë sistemike për mbrojtjen e të drejtave të palëve, përfshirë edhe të drejtat sociale. Parimet e përfshira në këtë ligj (ligjshmëria, siguria juridike, proporcionaliteti, efikasiteti, ndihma aktive ndaj palës dhe përcaktimi i së vërtetës materiale) janë në përputhje të plotë me standardet evropiane për administratë të mirë.

Megjithatë, analiza tregon se në ligjet e veçanta në fushën e mbrojtjes sociale, sigurimit pensional dhe invalidor dhe sigurimit shëndetësor, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra mbi bazën e tyre, shpesh përfshihen zgjidhje që në praktikë relativizojnë ose kufizojnë zbatimin e këtyre parimeve. Megjithëse parimet themelore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nuk janë deroguar zyrtarisht, mënyra në të cilën rregullohen procedura të caktuara mund të krijojë vështirësi për palët.

3.3. Konkluzione mbi zbatimin e ligjit procedural administrativ

Analiza e praktikës administrative tregon se secila nga dispozitat materiale ka një normë udhëzuese për zbatimin e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjatë zhvillimit të procedurës, si për realizimin e të drejtave të mbrojtjes sociale, ashtu edhe për të drejtat të sigurimit pensional dhe invalidor, si dhe për realizimin e të drejtave të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm. Prandaj, autoritetet kompetente gjatë vendosjes së këtyre të drejtave duhet të zbatojnë në mënyrë të vazhdueshme këtë rregullore formale, duke marrë parasysh frymën e ligjit, si dhe qëllimin e procedurës administrative për të siguruar ushtrimin efektiv dhe të ligjshëm të të drejtave të palëve, duke siguruar rolin aktiv të palës në të gjithë procedurën. Analiza tregoi se shumica e problemeve në qasjen në drejtësinë sociale administrative rrjedhin nga zbatimi jo konsistent i parimeve themelore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nga autoritetet publike. Veçanërisht dallohen dobësitë e mëposhtme:

- qasje formaliste në vendimmarrje, me këmbëngulje të tepruar në mangësitë formale të kërkesave;
- zbatimi i pamjaftueshëm i parimit të ndihmës aktive për palën;
- përcaktimi i pamjaftueshëm i së vërtetës materiale;
- akte administrative të pamjaftueshme, veçanërisht në rastet e refuzimit ose revokimit të të drejtave të fituara tashmë dhe
- zbatim i pamjaftueshëm i vendimmarrjes së merituar nga organi i shkallës së dytë.

Këto fenomene kanë një ndikim veçanërisht negativ në procedurat e të drejtave sociale, ku palët shpesh janë persona me nivel të ulët të njohurive juridike, burime të kufizuara financiare dhe me varësi të rritur nga ushtrimi në kohë i të drejtave.

3.4. Konkluzione mbi kuadrin institucional

Analiza institucionale tregon se ekziston një fragmentim i lartë i kompetencave midis organeve të ndryshme publike (qendra për punë sociale, fonde, komisione), gjë që e komplikon edhe më shumë procedurën për qytetarët. Është interesante se në secilën nga tre nënfushat (të drejtat e mbrojtjes sociale, të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor dhe të drejtat e sigurimit shëndetësor) ekziston një qasje e ndryshme lidhur me (mos)ekzistencën e ankesës dhe kompetencës për të vendosur mbi ankesën në procedurën administrative. Në këtë analizë, nuk kishte as hapësirë dhe as mundësi për të shqyrtuar kapacitetet aktuale në të gjitha autoritetet publike. Megjithatë, në periudhën e ardhshme, është e nevojshme të fillohet një proces i përgatitjes së analizave funksionale të të gjitha autoriteteve publike që hyjnë në kuadrin institucional për të drejtat sociale.

3.5. Konkluzione në lidhje me mbrojtjen administrativo-gjyqësore

Analiza pa mëdyshje tregon se mbrojtja administrativo-gjyqësore në sferën e të drejtave sociale nuk e ushtron plotësisht rolin e saj korrigjues dhe mbrojtës. Gjegjësisht, megjithëse ekziston një detyrim i qartë ligjor për të zgjidhur në juridiksion të plotë, Gjykata Administrative rrallë e përdor këtë mundësi, duke rezultuar në të ashtuquajturin "efekt pingpongu" dhe procedura afatgjata.

Vendoska e pamjaftueshme në juridiksion të plotë, së bashku me kthimin e shpeshtë të lëndëve në rigjykim, zgjat ndjeshëm kohën e nevojshme për ushtrimin e të drejtave sociale dhe minon besimin e qytetarëve në sistemin e mbrojtjes ligjore. Kjo është veçanërisht problematike nëse marrim parasysh se pikërisht në lëndët e natyrës sociale koha është thelbësore.

3.6. Konkluzion i përgjithshëm

Në përgjithësi, analiza tregon se problemi kryesor i qasjes në drejtësinë sociale administrative në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është mungesa e normave ligjore, por zbatimi praktik i tyre. Ekziston një hendek i qartë midis parimeve të shpallura në mënyrë normative dhe administratës dhe jurisprudencës aktuale.

Përmirësimi i qasjes në drejtësinë sociale administrative kërkon një qasje sistematike që do të përfshijë:

- përmirësimin e praktikës administrative dhe respektimin e parimeve të ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, si dhe të parimeve të ligjeve të tjera;
- analizën dhe forcimin e duhur të kapaciteteve institucionale (analizat funksionale të autoriteteve publike dhe politikat e ndërtimit të kapaciteteve të bazuara në prova);
- forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit administrativ, duke marrë parasysh numrin e madh të çështjeve të trajtuara, por edhe një ndryshim të jurisprudencës drejt një vendosjeje më aktive në juridiksion të plotë dhe
- afirmimin e vazhdueshëm të parimeve të drejtësisë sociale, solidaritetit dhe proporcionalitetit.

3.7. Rekomandime

Rekomandimi themelore për organet e shkallës së parë që vendosin në procedurë administrative, është që ato të jenë të kujdesshme dhe të zbatojnë dispozitat si të rregulloreve materiale ashtu edhe të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në veçanti, autoritetet duhet të respektojnë dhe zbatojnë parimet themelore të parashikuara nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Si pasojë e analizës së vendimeve gjyqësore, vihet re se dobësia ose paligjshmëria më e madhe e konstatuar në aktgjykime është përcaktimi i pasaktë i gjendjes faktike, mosveprimi mbi udhëzimet e vendimeve gjyqësore, dhe në disa raste edhe mosdorëzimi i dokumenteve. Një gjendje e tillë mund të tejkalohet duke ndërmarrë masat e mëposhtme: organet e shkallës së parë të përgatisin vendime me arsyetime të detajuara, të qarta dhe të sakta, nga të cilat të shihet qartë se si është përcaktuar gjendja faktike dhe cilat prova janë marrë parasysh gjatë vendimmarrjes, pa kontradikta, dhe duke përmendur qartë të gjitha arsyet për marrjen e vendimit.

Për organin e shkallës së dytë, është i rëndësishëm zbatimi i vazhdueshëm i nenit të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili u jep atyre mundësinë për vendimmarrje meritore dhe gjithashtu përgatitjen e vendimeve me shpjegime të qarta.

Për një mbrojtje efektive administrative-gjyqësore, Gjykata Administrative duhet të zbatojë dispozitat që lidhen me shqyrtimin e gjobave për moszbatimin e vendimeve, si dhe për mosdorëzimin e dokumenteve. Por, ajo që duhet të theksohet është se ligji i ri e prezanton kontestin administrativ me juridiksion të plotë si rregull, jo si përjashtim, prandaj Gjykata Administrative duhet të nxjerrë më shpesh vendime me juridiksion të plotë, veçanërisht në rastet kur padia është parashtruar disa herë për të njëjtën lëndë.

Përveç organeve, duhet të theksohet se edhe palët kanë një ndikim të caktuar mbi procedurën, prandaj çdo palë, gjatë paraqitjes së kërkesës për realizimin e një të drejte të caktuar, duhet të sigurojë të gjitha provat nga ana e saj (përveç provave që sigurohen me detyrë zyrtare), të cilat do t'i mundësojnë organit të përcaktojë saktë nëse janë përmbushur të gjitha kushtet e parashikuara në dispozitat materiale për njohjen e së drejtës përkatëse. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative i mundëson palës një rol aktiv në procedurë, prandaj ajo duhet të referohet në zbatimin e këtyre dispozitave dhe të marrë pjesë në çdo fazë të procedurës për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të saj.

Në lidhje me realizimin efektiv të mbrojtjes ligjore në procedurën administrative dhe kontestin administrativ, nga aktgjykimet e analizuara mund të nxjerrim disa gjetje dhe rekomandime.

Tabela Nr. 7 – Rekomandime për realizimin efektiv të mbrojtjes ligjore në procedurën administrative dhe kontestin administrativ

Nr.	Gjetje	Sygjerim
1	Nuk ka të dhëna për zbatimin e vendimeve gjyqësore.	Të parashikohet një detyrim për organet që të njoftojnë Gjykatën Administrative për veprimet e ndërmarra mbi vendimin e gjykatës, ndërsa Gjykata Administrative të përgatisë një Raport për numrin dhe mënyrën e zbatimeve të vendimeve të saj.
2	Nuk respektohet afati i parashikuar nga Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative për veprimin mbi kërkesën e palës.	Të respektohen dispozitat për përgjegjësinë disiplinore për mosveprimin brenda afatit ligjor.
3	Organi i shkallës së dytë shpesh nuk vendos në mënyrë meritore	Zbatimi konsistent i nenit 109 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili parashikon vendimmarrje meritore në pikat 10 dhe 11.
4	Mosveprimi sipas udhëzimeve të gjykatës dhe zbatimi efektiv i vendimeve gjyqësore	Zbatimi konsistent i nenit 88 të Ligjit për Konteste Administrative për zbatimin e aktgjykimeve
5	Mosparaqitja e dokumentacionit në Gjykatën Administrative nga ana e të pandehurit, gjegjësisht mosrespektimi i dispozitës së Ligjit për Kontestet Administrative për dorëzimin e dokumentacionit	Zbatimi konsistent i nenit 33 pika 6 të Ligjit për Kontestes Administrative



www.ihr.org.mk